



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Punëjeto/Pratato Received/ Delivered	28.03.2022	2 viti god years
Organ /Rrjeta Organ /Jedinita Org /Unit	SKDMSHCK	1632/2022
Num. Prot. Pr. Prot. Prot No		
Shtojca Prilog Appendix		
Sasia Kolicina Quantity		113



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A. Nr. 147/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.147/2022, të datës 22.02.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë banimi [redacted] nga Komuna e Vushtrisë, kundër organit të punësimit Akademia e Kosovës për Siguri Publike, në çështjen juridike " vlerësim i punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa A.nr. 147/2022, e datës 22.02.2022, e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. MBETETE NE FUQI, vlerësimi i rezultateve në punë, për vitin 2021, për nëpunësin Civil [redacted] nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.
- IV. Vendimi hynë në fuqi në ditën e ndëshkimit nga Kryetar i Kolegjit.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] sipas shkresave të lëndës i punësuar në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, me datë 22.02.2022, me numër protokolli 917/2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me vlerësimin vjetor për vitin 2021, me arsyetim se vlerësimi vjetor, është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.02.2022, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek institucioni punëdhënës gjegjësisht tek Akademia e Kosovës për Siguri Publike. Ndërsa me datë 08.03.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë të ankuesit si dhe shkresat lidhur me lëndën.


Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e datës 22.02.2022, e parashtruar nga ankuesi me numër protokollit 917/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021, për ankuesin

Raporti i Vlerësimit të Trajnimit; Raporti i vlerësimit të Trajnimeve „Trajnimi Elementet Bazike të Menaxhimit“; Raporti nëntëmuor Janar- dhjetor i vitit 2021; Raporti Janar Qershor i vitit 2021; Plani i trajnimeve për vitin 2021; e- mali i datës 13.01.2022; Plani i Punës; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021; Përshkrimi i detyrave të punës; Ndryshimi dhe plotësimi i akt Emërimit i datës 30.06.2016; Akt Emërimi i datës 06.09.2011; Përgjigje në Ankesë e datës 08.03.2022, me numër protokollit 1231/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Bazuar në vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin Agron Avdiu, Kolegji konstaton se ankuesi është vlerësuar nga Udhëheqësi i Divizionit të Trajnimeve, me notën e përgjithshme 4.2, ndërsa formulari i vlerësimit të punës nga ana e Udhëheqësit të Divizionit të Trajnimeve të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, gjegjësisht mbikëqyrësit të drejtpërdrejt është nënshkruar me datë 30.02.2022, një datë që nuk ekziston në kalendarin zyrtar që përdoret në Republikën e Kosovës, Kolegji konstaton se një datë e tillë është shkruar gabimisht dhe merr si të mirëqene si gabim teknike.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka analizuar pretendimet ankimore të ankuesit, sa i përket përmbajtës së datës të formularit të vlerësimit, në vende që të jetë data 31.01.2022, nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë është bërë me datë 30.02.2022, kolegji konstaton se perëndimet ankimore janë në pajtim me nenin 43, paragrafi 1,2.3. dhe 4 të Ligji nr. 06/1 - 114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet; 1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues, sepse në dukje të parë datë është jashtë afatit ligjor, por siç është thënë më lartë Kolegji konstaton se një datë e tillë është gabim teknik dhe vlerësimi duhet të konsiderohet në kuadër të afatit ligjor të paraparë për një gjë të tillë.



Ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se KPMSHCK, pas shqyrtimit të ankesës të aprovoje ankesën e ankuesit dhe vlerësimin e rezultateve në punë me notën e përgjithshme katër pike dy (4.2), ta ndryshojë me notën e përgjithshme me notën pesë (5), Kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë të bazuara sepse ankuesi ka vlerësim me notën e përgjithshme 4.2 dhe se vlerësimi i rezultateve në punë nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë është bërë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se organi i punësimit Akademia e Kosovës për Siguri Publike, pas pranimit të vendimit të Këshillit është i obliguar që në dosjen e nëpunësit civil [redacted] ta vendosë edhe Vendim të KPMSHCK-së, për arsye të vendosjes në formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021, i bërë nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë është vendosur data 30.02.2022.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkrësive të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

*Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr. 147/2022*

Rushit Kajtazi
Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Akademinë e Kosovës për Siguri Publike;
- Udhëheqësit të Personelit në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike;
- Arkivit të KPMSHCK-së,

